



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:006049

Datë: 25.10.2023

Numri i dokumentit: 04826719

NE EMËR TË POPULLIT

P.nr.129/2022

GJYKATA THEMELORE PEJË – Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Leon Përlaska dhe procesmbajtësja Shpresa Kërnja, në çështjen penale kundër të pandehurit A. H. , nga fshati N., komuna e Pejës, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë- Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.2671/2021 të datës 15.02.2022 për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 par.8 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 24.10.2023, në prezencë të prokurorit së shtetit Dorjan Juniku, si dhe të pandehurit më mbrojtësin e tij të autorizuar av. Kadri Prekaj, të njëjtën ditë mori, shpalli dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

A. H. , i lindur me, në fsh.N. K-Pejë – isht rr.A. L. pa nr. i biri i H. dhe nenës F., e vajzërisë S., i identifikohet në bazë të Inj.nr. personal – lëshuar nga MPB R-Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor në ETC, i gjendjes së dobët ekonomike, i pa martuar, shqiptar, shtetas i R. së Kosovës.

SHPALLËT FAJTOR

Për shkak se :

Me datën 20.08.2021, rreth orës 20:30 min në aksin rrugor Pejë – T., pikërisht në rr. “F.A.” K. Pejë, nga pakujdesia ka shkelur nenin 53 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor, në atë mënyrë që përderisa i pandehuri ishte duke vozitur automjetin e tij të markës VË P. me targa 03-...-..., kur arrin ne vendin e lartcekur nuk e përshtat shpejtësinë e lëvizjes me kushtet e rrugës, ashtu që edhe pse e vëren se këmbësorja - e dëmtuara Z. L. kishte filluar për ta kaluar rrugën nga ana e majtë ne anën e djathtë, i pandehuri nuk arrin që ta ndal veturën para se ta godas te dëmtuarën, ashtu që pasi e dëmtuara e kalon shiritin e djathtë, i pandehuri me pasqyrën e anës së majtë te

veturës e godet të dëmtuarën Z. dhe pas goditjes e rrezon për toke, e si pasojë e aksidentit sipas ekspertizës ligjore të punuar për rastin lëndime të rënda trupore ka pësuar e dëmtuara Z. L..

- me këtë ka kryer veprë penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 par. 8 lidhur me par. 6 dhe 1 të KPRK-së.

Prandaj në kuptim të nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe nenit 38, 39, 40, 42, 46, 48, 49,69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074):

GJYKON

Të pandehurit A. H. i shqipton:

DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari nuk do të kryej veprë tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej 2 vitesh, që do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Obligohet i dënuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 euro dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim.

Kërkesë pasurore juridike nuk pati nga i dëmtuari.

A R S Y E T I M

Historiku i çështjes dhe vendimi në lidhje me fajësinë;

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm me datë 15.02.2022 pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.2671/2021 kundër të pandehurit A. H. për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 par.8 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së.

Kjo gjykatë me datë 24.10.2023, e mbajti seancën e shqyrtimit fillestar në të cilën prezantuan prokurori i shtetit Dorjan Juniku si dhe i pandehuri me mbrojtësin e tij të autorizuar av.Kadri Prekaj, në të cilën seancë i pandehuri u deklarua se e pranon fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë.

Pas marrjes së mendimit të prokurorit të shtetit dhe në kuptim të nenit 248 par.1 dhe 4 të KPPRK-së gjykata vendosi që të aprovoj pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri, pasi që është e qartë se i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe provat e pranueshme që e mbështesin aktakuzën dhe se aktakuza nuk përmban shkelje të qarta ligjore ose gabime faktike.

Pas aprovimit të pranimin të fajësisë nga ana e gjykatës, prokurori i shtetit deklaroi " Duke marrë parasysh se këtu i akuzuari e pranoj fajësinë konform kushteve ligjore të parapara me nenin 242 të KPPRK-së, nga gjykata kërkoj që të njëjtin ta shpall fajtor, ta dënoj sipas ligjit si dhe ta obligoj në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale. Ndërsa me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit praninë fajësisë ta vlerësoj si rrethanë lehtësuese, ndërsa në kuptim të dispozitave ligjore të nenit 70 të KPPRK-së, si rrethanë rënduese të vlerësoj shkallën e dëmit ngase e dëmtuara si pasojë e goditjes me veturë nga i pandehuri ka pësuar lëndime të rëndë trupora."

Mbrojtësi i pandehurit deklaroi " Sa i përket dënimit kërkoj nga gjykata që me rastin e shqiptimit të dënimit për nga lloji dhe lartësia të ketë parasysh se i mbrojturi im pos që bëri pranimin e fajësisë, shprehi keqardhje për atë rast që i ka ndodh, nuk ka qenë më parë i dënuar e as që ka rëndesh me ligjin, është mbajtës i vetëm i familjar, gjendjen ekonomike nuk e ka të mirë, gjatë gjithë kohë sa ka qenë e dëmtuara ka tregu kujdes dhe ka komunikuar me djalin e saj Gani Lajqi, është shku dhe e ka pa në spital, vetë e ka dërgu në spital pas aksidentit, e l us gjykatën që të ketë parasysh këto rrethana dhe t'ja shqiptoj një dënim sa më të butë për nga lloji dhe lartësia".

I pandehuri deklaroi "Pajtohem në tërësi me deklarin e mbrojtësit tim, ditën e aksidentit kam qëndruar në spital deri në orën 11 të natës, prej aty kam shkuar vetë dhe jam lajmëru në Polici dhe ju kam treguar për aksidentin, edhe njëherë deklaroj se me vie shumë keq që ka ndodhë ai rast".

Vendimi lidhur me dënimin;

Gjykata kur vendosi të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u bazua në dispozitat 38, 39, 40, 42, 46, 48, 49,69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074) dhe atë duke vlerësuar rrethanat lehtësues dhe rënduese të çështjes.

Për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i pandehurit ligjvënësi ka paraparë mundësin e shqiptimit të dënimit me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet, e në këtë rast gjykata ndaj të pandehurit vendosi që të shqiptoj dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohen nëse i dënuari nuk do të kryej vepër tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej 2 (dy) vitesh, që do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Duke i analizuar faktet e çështjes, gjykata erdhi në përfundim se në lidhje me të pandehurin nuk kemi fare rrethana renduese, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata e gjeti pranimin e fajësisë të bërë nga të pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestar dhe keqardhjen e shfaqur nga i pandehuri me rastin e pranimit të fajësisë, gjithashtu si rrethanë lehtësuese mori edhe interesimin dhe kujdesin nga ana e të pandehurit ndaj të dëmtuarës pas ndodhjes së rastit, ku duke u nisur nga këto rrethana dhe në kuptim të nenit 38 dhe 42 të KPRK-së gjykata vendosi që ndaj të pandehurit të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata në dispozitiv të aktgjykimit vendosi që të pandehurit të shqiptoj dënim me burgim prej një (1) viti i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari nuk do të kryej vepër tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej 2 (dy) vitesh, që do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kur u vendos për kushtëzimin ekzekutimit të dënimit me burgim gjykata u bazua në nenin 46, 48 par.1 dhe 2 dhe 49 par.1 dhe 3 të KPRK-së.

Gjykata vlerësoj se me shqiptimin e dënimit më kusht ndaj të pandehurit do të arrihet të realizohet në tërësi qëllimi i dënimit, pasi që ky dënim do të ndikoj në rehabilitimin e të pandehurit, në parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale dhe në mënyrë të arsyeshme shpreh gjykimin shoqëror për veprimet e kryerësit . Tërheqja e vërejtjes të pandehurit se nëse në periudhën verifikuese prej dy (2) vitesh do të kryej vepër tjetër penale ndaj tij do ekzekutohet dënimi me burgim si në dispozitiv të aktgjykimit, është një paralajmërim serioz që të parandaloj të pandehurin në kryerjen e veprave penale në të ardhmen.

Gjykata e shqiptoj dënimin më kusht në përputhje me nenin 49 par.1 të KPRK-së ku thuhet “Dënimi me kusht mund t’i shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilën me ligj është paraparë dënimi me burgim deri në pesë (5) vjet”, e në këtë rast siç u përshkrua më lartë për veprën penale

qe është shpallur fajtor i pandehuri është paraparë mundësia e shqiptimit të dënimit me burgim prej gjashtë (6) muaj deri ne pesë (5) vjet.

Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar të pandehurit, është në përputhshmëri të plotë me qëllimin e dënimit të përcaktuar në nenin 38 të KPRK-së dhe se ky dënim do të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale te ngjashme dhe shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer nga i pandehuri.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale për paushallin gjyqësor u mor në kuptim nenit 450 par.1 dhe par.2 nën paragrafi 2.6 dhe nenin 453 par.1 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me taksën për kompensimin e viktimave të krimit, u mor në bazë të nenit 39 par.3 të Ligjit 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit.

Kërkesë pasurore juridike nuk pati nga i dëmtuari, siç parashihet nenin 458 par.1 të KPRK-së, si rrjedhojë gjykata nuk vendosi për kompensim të dëmit e as nuk e udhëzoi në kontest civil të dëmtuarin.

Andaj, duke u mbështetur në fakte e parashtruara dhe dispozitat ligjore nga neni 365 dhe 370 të KPPRK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr.129/2022, me datë 24.10.2023

Procesmbajtësja:
Shpresa Kërnya

Gjyqtari i vetëm gjykues
Leon Përlaska

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga pranimi i të njëjtit, ankesa paraqitet në këtë gjykatë për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.